



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 649/25 Dt. 22.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 17 dhe 30 të Ligjit 06/L-85 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, të Rregullores nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për zëvendësimin e zyrtarit përgjegjës për të pranuar dhe trajtuar sinjalizim

1. Naim Kukaj, zyrtar i lartë ligjor në Komunën e Prizrenit, e zëvendëson Adonita Karavidaj- zyrtare ligjor në Komunën e Prizrenit, e cila është e caktuar me vendim 01 nr. 462/25, datë 28.07.2025, si zyrtare përgjegjëse për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin brenda Komunës së Prizrenit.
2. Detyra dhe përgjegjësit e zyrtarit zëvendësues si në pikën 1 të këtij Vendimi janë të parapara në Ligjin 06/L-85 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 22/2018), Rregulloren nr. 03/2021, për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi.
4. Obligohen zyrtarët përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij dhe vlen deri në kthimin e zyrtares përgjegjëse për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin brenda Komunës së Prizrenit nga pushimi pa pagesë ose deri në revokimin e këtij vendimi.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurve,
 - Agjencisë Kundër Korrupsionit,
 - Arkivës së Kryetarit.

